

Kartëmbajtësit

Funksionet dhe tiparet e sigurisë të kartave Chip janë të bazuara mbi një teknologji të provuar.

Tiparet

- Transaksionet me karta Chip nuk kërkojnë firmosjen e faturës dhe autorizohen nëpërmjet përdorimit të Numrit Personal të Identifikimit (PIN).
- PIN-i përdoret për të vërtetuar të gjitha transaksionet e bëra me kartat Chip.
- Kartat Chip futen në терминаlet e pagesave (nuk kalohen në lexuesin e shiritit magnetik) dhe qëndrojnë në terminal deri sa transaksioni të jetë kryer.

Avantazhet

- Kartat Chip paraqesin më tepër siguri në kryerjen e transaksioneve pasi kanë mekanizma të përfeksionuar që mbrojnë në mënyrë efikase nga mashtrimet dhe kopjimet e kartave.
- Transaksionet vërtetohen nëpërmjet PIN-it, gjë që redukton më tej situatat e mundshme të mashtrimit.
- Kartat Chip kanë një shirit magnetik që i lejon ato të përdoren edhe kur teknologjia e Chip-it nuk është e pranishme në terminale të caktuara.
- Kartat e reja janë plotësisht në përputhje me skemat e pagesave që janë vënë tashmë në përdorim pothuajse kudo jashtë vendit.
- Kartat me Chip, thjeshtojnë dhe zvogëlojnë kohën e përpunimit të transaksionit pasi tregtarit nuk i duhet të verifikojë firmën e klientit.

Pranimi i Kartave

Kartat Chip të lëshuara nga Intesa Sanpaolo Bank Albania vazhdojnë të kenë një shirit magnetik i cili pranohet kudo ku teknologjia Chip nuk është e pranishme.

Kur do të zëvendësohen kartat e Bankes Intesa Sanpaolo?

Të gjitha kartat e Bankës Intesa Sanpaolo do të zëvendësohen duke filluar nga Janari deri 16 Prill 2011.

Me marrjen e kartës suaj me Chip në njërin nga degët e bankës sonë, ju duhet të dorëzoni kartën tuaj të vjetër me shirit magnetik.

A do vazhdojnë të pranohen kartat me shirit magnetik?

Pas 30 Prillit 2011, ju do të jeni në gjëndje të përdorni vetëm kartat me Chip të lëshuara nga Intesa Sanpaolo Bank Albania. Për këtë arsye, sigurohuni që të pajiseni me kartën tuaj të re me Chip përpara kësaj date.